



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2011"), nenit 12 paragrafi 1 pika 1.6 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

1. **MIRATOHET** Raporti i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Rahovecit për periudhën janar – dhjetor 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Rahovecit për periudhën janar – dhjetor 2025 me Nr. Prot. 621 i datës 23.01.2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Komisionit Qeveritar për Vlerësim të Dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe Fatkeqësit e Tjera,
- Agjencisë për Menaxhimin Emergjent,
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 91/26
Datë:26.01.2026

